



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:215447
Datë: 22.01.2025
Numri i dokumentit: 06744110

C.nr.736/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Feim Bytyqi, me bashkëpunëtorin profesional Armond Omega, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.B, B.K, D.S, E.Z, J.K, V.M, Z.R, të gjithë punëtor në QKMF Rahovec, të cilët me autorizim i përfaqëson F.S avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 13,193.41 euro, jashtë seancës, me datë 22.01.2025, bie këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve B.B, B.K, D.S, E.Z, J.K, V.M, Z.R, me të cilën kanë kërkuar që të: “DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit që paditësve: B.B, t’ia paguaj shumën në vlerë prej 1,295.73 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore, B.K, t’ia paguaj shumën në vlerë prej 1,342.95 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore, D.D, t’ia paguaj shumën në vlerë prej 1,300.47 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore, E.Z, t’ia paguaj shumën në vlerë prej 2,585.13 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore, J.K, t’ia paguaj shumën në vlerë prej 2,929.56 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore, V.M, t’ia paguaj shumën në vlerë prej 1,295.73 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore, Z.R, t’ia paguaj shumën në vlerë prej 2,444.01 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore në total 13,193.41 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 724.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit B.B, B.K, D.S, E.Z, J.K, V.M, Z.R, përmes të autorizuarit të tyre av.F.S nga Gjilani, me datë 31.07.2024 pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar kompensimin nga marrëdhënia e punës të përshkruara më për së afërmi si në padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi të paraqitur në gjykatë me datë 11.11.2024, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, me arsyetimin se nuk i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 17.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi për shkak të parashkrimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj

tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë dhe përgjigjes në padi të parashtruar nga e paditura, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:
Kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar.

Gjykata para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestuese, ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 399.1 i LPK-së me të cilin është paraparë që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit ishin në marrëdhënie pune tek e paditura në QKMF Rahovec. Këtë fakt gjykata e vërtetoi me shqimin e kontratave së punës; listës së pagës.

Kontestuese në mes palëve ishte nëse paditësve i takon e drejta për shpërblim jubilar.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021. Me nenin 17 par. 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se *“Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”*.

Me administrimin e provave materiale dhe atë Listës së pagave është vërtetuar periudha kohore se kur – në cilin vit paditësit kanë arrit vitin jubilar gjegjësisht është vërtetuar fakti se:

- Paditësja B.B vitin e 30 jubilar e ka arritur në vitin 2014, në bazë të listës së pagave të datës 30.11.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja kishte 39 vite përvoj pune.
- Paditësja B.K vitin e 30 jubilar e ka arritur në vitin 2016, në bazë të listës së pagave të datës 30.11.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja kishte 37 vite përvoj pune.
- Paditësja D.S vitin e 30 jubilar e ka arritur në vitin 2013, në bazë të listës së pagave të datës 31.05.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësja kishte 38 vite përvoj pune.
- Paditësi E.Z vitin e 30 jubilar e ka arritur në vitin 2018, në bazë të listës së pagave të datës 31.05.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte 33 vite përvoj pune.
- Paditësi J.K vitin e 30 jubilar e ka arritur në vitin 2020, në bazë të listës së pagave të datës 31.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte 31 vite përvoj pune.
- Paditësja V.M vitin e 30 jubilar e ka arritur në vitin 2014, në bazë të listës së pagave të datës 30.11.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja kishte 39 vite përvoj pune.
- Paditësi Z.R vitin e 30 jubilar e ka arritur në vitin 2018, në bazë të listës së pagave të datës 31.05.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte 33 vite përvoj pune.

Për paditësit B.B, B.K, D.S, V.M, gjykata ka vendosur të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë për faktin se paditësit B.B, B.K, D.S, V.M kanë kërkuar një pagë mujore për shpërblimin jubilar të vitit 30 të punës, ndërsa në të vërtetë për periudhën për të cilën kanë kërkuar, në vitin e 30 jubilar të tyre, nuk kishte Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, periudha për të cilën paditësit e kërkojnë shpërblimin jubilar, nuk ka ekzistuar Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, paditësit janë thirrur në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, por sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në nenin 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë parashihet *“afati i zbatimit të kësaj kontrate është në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga data e lidhjes së saj, respektivisht nga momenti i nënshkrimit nga palët në këtë kontratë, dhe gjen zbatim deri në lidhjen e kontratës së re”* respektivisht e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021.

Ndërkaq për kërkesën e paditësve E.Z, Z.R, në bazë të listës së pagave të datës 31.05.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësit kishin 33 vite përvoj pune, të cilët vitin e 30 jubilar e kanë arritur në vitin 2018, ndërsa paditësi J.K, në bazë të listës së pagës të datës 31.05.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte 31 vite përvoj pune, të cilët vitin e 30 jubilar e kanë arritur në vitin 2020, atëherë te të njëjtit nga kjo datë ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar. Andaj nga data kur ka lindur kërkesa për kompensimin e shpërblimit jubilar, e deri në datën e parashtrimit të padisë kanë kaluar më shumë se 3 vite. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 31.07.2024. Andaj, në rastin konkret edhe e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 399 të LPK-së gjykata nuk gjeti ndonjë nga bazat për aprovim të kërkesëpadisë andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.736/2024, më datë 22.01.2025

Bashkëpunëtor profesional
Armond Omega

Gjyqtari
Feim Bytyqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:215447
Datë: 22.01.2025
Numri i dokumentit: 06744110